

ROLAND MUSTA

8915-1

M. 98

**NĒPĒR
AGIME**

8915-1
M 98

ROLAND MUSTA

NËPËR AGIME

(Poezi)

LIBRERIA E SHËTIT
DITËN DHE DITA

46509
13858

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

PERSERI

1.

Agimi çeli tej në horizont
Me buzëqeshje u ngjye mëngjezi,
Sheshi i madh nga zërat zhurmëron,
Përsëri në udhët na thërresin.
Derdhu buzëqeshje nëpër fusha
Se rinia vërshoi në aksione,
Llampa dhe pëllumba mban në duar
Të ndriçojë guvat edhe honet!
Kështu ndodh gjithmonë me rininë
Që hedh shtat aksioneve të blerta,
Dhe përhap në majë krenarinë,
Kur ngjit vrullshëm lartësitë e kthjellta.

2.

Ti e di,
 tani erdh sërish vera
Dhe ne do shkojmë
 të parët në aksion.
Ku mbi supe
 flamujt shpalos era
Dhe qyteza zjen
 gjer natën vonë.
Të kujtohet vitin e kaluar?...
Sa traversa shtruam mbi trase,
Dhe kur vrisje ti të voglat duar
Mua,
 të menduar shpesh më pe...
Flinim në baranga pupuliti
Që me duart tonë,
 vetë i ngritëm.
Dhe të kaltrat ëndrra i flladiti
Era,
 që harlisej me dritën...
Me ne ish dhe cuca malësore
Që zbriti nga rrafsh' i Dukagjinit
Me 'të këngës
 sa herë ja mora,
Kur së bashku në qytezë vinim...
Ajo ra...
 dhe ne mund të binim
Tek rritej traseja e lartë,
Dhe rininë
 përjetësisht ta linim
Përmbi tokën tonë si dhuratë.
Ti e di,
 ky është ligji ynë.

Vazhda e heroizmit
gurgullon,
Ndaj s'e mposht thëllimi
kurrë rininë,
Se hedh shtat
dhe rritet në aksion.
Shumë kazma ngritëm përmbi supe
Shumë brázda hapëm nëpër tokë,
Dhe s'i ndalim asnjëherë sulmet
Se prej tyre
dalim më të fortë!

3.

Një shirit ylberi ra mbi kodra
Si një shall vigan
Kjo rini
Në një sfond
Udhët zgjaten
Udhët shpliksen larg.
Përmbi tokë lavdia gjelbëron,
Vala e gëzimit shtigjet hap,
Ne sërisht po shkojmë në aksion!...

PARTISË SIME

Më thërret koha
të shkruaj poema të reja,
Ku fark' e revolucionit
çdo varg të ndrisë,
Këtu unë frysëzimin e gjej,
Në epokën e madhe të partisë.
Dyndje mendimesh
vërshojnë rreth meje,
Si formacionet e ushtarëve në luftime,
Të gatshme për front,
pa rënë buria,
Armikun të vrashin me predhën e parë,
Të mbetet i shënjtë
ideali,
partia!

* * *

Kohrat pollën regjime,
mbretërima
Dhe me gojën e tyre të lashtë
i përpinë,

Në kohrat që erdhën
Revolucionet gjëmoi breshëria,
lindën

P A R T I N E .

* * *

Si skulptori që gdhendi veprën me daltë,
Ku të gjallë shohim
të renë aktiviste,
Mendim' i partisë
i thellë,
i qartë,
Mbi atdheun gdhend
të ardhmen komuniste.
Motet me erëra,
ditët me shtrëngata
Ty të hodhën mbi kokë
veç brymë vitesh,
Por forca jote frëngëllon si shpata,
Arterie ke popullin,
përpyjetë do rritesh!
Në ritmet e kuqe të pesëvjeçarëve,
Në fishkëllimat grijë të sirenave
Fjala jote shpërthen si fishekzare
Mbi tokën e lashtë,
ndrit kulmet e antenave,
Dhe kaq dritë s'panë kurrë këta male,
Kaq këngë,
bukë
dhe krenari,

Diva sot janë bërë hidroçentralet,
Që shpérndajnë gjëzimin
jugë-veri.

* * *

Unë jam ushtar agjитator,
Njeriu i shqetësuar
i alarmeve,
Për të mbrojtur ty
dhe trollin arbëror
Supit me kallo' mbaj rrotypat e armëve.
Si ta vazhdoj më tej këngën për ty,
Kur t'i mbart kaq heroizma,
Që gërshtohen me jehonën partizane...
Ndofta të këndojaq mirë nuk di,
Por luftëtar,
unë jam
dhe në tufane.
Marshojmë.
Gjithmonë përpëra,
me ballin lart
Agime ngjyrë flake
për né vijnë,
Partia—
vullkani më i zjarrtë,
Partia —
konstelacion vigan
për Shqipërinë!

1966.

KAM BUSULL TË NDRIITSHME

Jam ndalur shpinë kodrës të pushoj,
I dirsur prej marshimeve të gjata,
Si nga kurrise devesh po vështroj:
Qielli i kaltër digjet... zbut nata.

Hëna rrëshqet si anije antike,
Që velat i mbenë diku në beteja.
Unë eci mes shtigjesh t'egra
 epike,
Mbi tokën e lashtë
 mbartëndërra të reja.
Kam busull të ndritshme,
 s'më duhen yjet,
E di pikndodhjen,
 ku do jem në mëngjes,
S'më trembin guvat,
 s'më ndalin pyjet,
Me pushkën mbi sup
 agimet pëershëndes!..

NE ZBOR

E ke vështirë moj žboriste,
Të mbushësh armën me shpejtësi,
Dhe në lëvizjet me zvarritje
Ti mbete prapa përsëri...

Lëvize trupin rrafsh me tokën,
Që plumb' i hasmit mos të marrë,
Më shpejt, më shpejt, arrije togën!
S'ka gjë në është hér' e parë,
Do vish sërish këtu,
në zbor,
Me pushkë, çantën përmbi shpinë,
Me vrull dhe zjarr në kraharor,
Kalitemi për Shqipërinë.

KËNGA USHTARAKE

Jam midis ushtarëve të thjeshtë,
 Që më duan
 dhe kaq shumë i dua.
 Ndai më sheh, atdhe, me ta në rreshta
 Mbrëmjeve të purpurga
 të tua.

Po.

Si komandant

 unë jam i rreptë,
 Se në gjak e kam të kërkoj rregull,
 Dhe për vogëlsira s'jam i qetë:
 Por, transhen e gjej
 edhe në mjegull.

Më ke parë, shok, dhe në stërvitje,
 Në thëllim e shqotë më ke parë,
 Kur mbi borë zë pozicion për qitje,
 Dhe pastaj me radhë gjithë ushtarët.

Eshtë e bukur sot jet' e ushtarit,
 Se mbi sup mban kazmë edhe pushkë,
 Që t'i japim gjallëri ugarit,
 Që ta bëjmë pjellor malin si fushën.

Ja këtu mes njerëzish,
në punë,
Kur kërcasin drizat përmes flake,
Gjithë e freskët çeli dhe tek unë
E sinqerta këngë ushtarake!

1967.

NJË MBLEDHJE

U mblohdëm këtu ndanë detit
Të gjithë, ushtarë, oficerë,
Kur shplekseshin valët ne ndjenim
Shqetësimin e punës më thellë...
Bisedonin valët me erën,
Këtu në prehër të bregut
Të rrahim të metat ne erdhëm,
Siç rrighet në kudhër një hekur.
Kritika si vala e rëndë
U përplas,
vogëlsirat thërmoi.
Dikush lëvizi prej vendit...
Dikujt djersa në ballë i rëndoi.
Deti përhapte erë jod,
Dhe mbrëmja mbante lagështirë,
Kritika qëlloi e ashpër,
e fortë
Në mbledhjen tonë të lirë...

... NË DHOMË

Lindin mendimet
në dhomën time;
Po këto çaste
dua të nis dy vargje
në jetë,
Shoku imiqep qaforen në xhaketën
e përhime,
Ndërsa radioja
jep lajmet,
Komunizmi troket
entuziast
mbi planet!

NË KËTË QYTET

Gurët e ashpër të këtij qyteti
I vura në themel të këngëve
dikur.

Dhe këtu më lindën
 të gjitha dashuritë
Që hodhën shtat të shëndetshme
 si fëminia.

Tani dëgjoj hapat e rënda
 që dikush troket...
Unë bredh me heronjtë e poemave të mia
Mbi kalldrëme,
 sonte
 në këtë qytet...

ATE QË DOJA...

Atë që doja
Vetëm një herë e ndoqa pas.
Një ditë,
Një vjeshtë.
Kur moti kish fshehur kaltërsitë
Si vajza dashurinë e fshehtë...

Atë që doja
E ndoqa pas një ditë,
Një vjeshtë,
Dhe tani buron nga thellësitë
Kjo këngë e largët,
e thjeshtë...

P O E Z I

Unë shkruaj poezi,
Që mes njerëzve
të ulet këmbëkryq.
Me ta,
si shok i mirë
kudo të jetë,
Dhe mua
të më shpjerë te të gjithë;
Kështu si jam,
i dashur,
i singertë.

Poezi —
agitatore e fortë e partisë
Qëllon zjarr pér zjarr.
Si këmbanë revolucioni
na mbledh,
e thërret!
Mendimin e struktur
anemik
Zhurit
Si fletërrufetë!

13858

46509

Ç A S T

I vështirë është çasti i ndarjes,
Këng' e ndarjes është e vështirë,
Si t'i them unë sonte vullnetares,
Mirupafshim, apo lamtumirë?

Ndarja e pashmangshme qëndron sonte
Pas ugaresh, tjetër shteg na pret.
Pse mendohe kaq, moj leshrabjonde,
Me shqetësimë mendjen pse e vret?...

I vështirë qenka çasti i ndarjes,
Fjalëve të fundit iu ndjej afshin;
Do t'i them ünë sonte vullnetares
Në të tjerë aksione mirupafshim!

ME THERRESIN UDHET...

Nesér do iki, nesér do iki,
Atdheu më rriti për udhë,
Mbi spond të maqinës
i pari do hipi,

Kur krahët
i tundin flamurët.

Qytezë, e dashur qytezë,
Si u bëmë kështu,
të pandarë,
Të zgjova me këngë
kaq mëngjeze,
Më thuaj tani...
«Udhembarë!..»

Nesér do iki, nesér do iki,
Atdheu më nisi për udhë,
Koha,
motivet e pastra do rriti,
Që mblodha te ty,
hekurudhë.

TE MALESORET

Mbrëmë ishim te Prenk Deda,
Të çuditshëm malësorët tanë,
Duhanin dhe barutin në xhep
Përzier bashkë i kanë.

Lindi një vocrrak mbrëmë atje,
Të qarën përshëndeti zil' e mushkës,
Xha Prenka buzëgas i uronte:
«Deka t'kjoft në gryk të pushkës! . »

1966

VALLËZO VOGËLUSHE

Unë e lashië vallëzimin përgjysmë,
Se n'ato çaste
 ashitu duhej lënë,
Dhe në shtigje të tjera më nisën,
Ku çdo hap më ndiq
 e bardha hënë...

Ndaj vallëzo vogëlushe, e qetë,
Largoi mendimet e kota,
Unë do vij si një stinë e blertë
Pas një dimri të egër ndër shqota.

KËNGA „VULLNETARE“

Ndënë fërfëritje flamujsh
Mijëra duar token,
Dhe brohorasin mijëra vullnetarë,
Të begatë do ta bëjmë tokën
Me vrullin tonë, vrullin djaloshar.
Kazmat shkëlqejnë përmbi supe,
Kjo armatë e re aksioniste,
Me fjalën e partisë kudo sulet
Drejt shtigjeve të ndezura — komuniste.
Vështroj me krenari shokët e dirsur
Përkulur përmbi brazdat e ugarit,
Sikur vështroj atdheun më të rritur
Nga hovi i rinisë që ngjitet malit.

Kaq të qeshur sot ata më duken
Tek thërrmojnë shkëmbinjtë me nxitim,

Ky është aksioni ynë
i madh
për bukën,
Ndaj malet i sulmojnë me guxim.

Ndënë harqe kazme kumbon kënga jonë
Për tokën, që 'më tjetër po e ngjeshim,
Dhe radhët si ushtarë i shtrëngojmë,
Që kënga të jehojë brez pas brezi...

...
...
...
...
...
TARRACAT
...
...
...
...

Në qoftë se malet do thinjen nga vitet
Si luftëtarët në t'ashprat beteja,
Tarracat që hapi ushtria
Në shekuj do mbeten të reja!..

1966

3. TREGIMI AKSIONI
TRENDI I KOMUNISTIKU SRIJEDNIK

“TREGIMI AKSIONI”
TRENDI I KOMUNISTIKU SRIJEDNIK
TRENDI I KOMUNISTIKU SRIJEDNIK

TREGIMI AKSIONI
TRENDI I KOMUNISTIKU SRIJEDNIK
TRENDI I KOMUNISTIKU SRIJEDNIK
TRENDI I KOMUNISTIKU SRIJEDNIK

Këtu hedh rrënëjë tregimi im;
Ku vend ka zënë travers' e parë,
Ku shtynim karrot me një frysë
Dhe t'ashprat duar i kam vraë.

Netve kur muzgjet pinin ujra
Dhe shkisnin larg në perëndim,
Ne ngrnim skelat përmbi ura,
Ku zgjatej kënga pambarim...

Qëllonin ditë me suferina,
Por kazma
 mbi ylber ngrihej,
Se toka priste në gjoks shinat
Si trimi armët
 dhe pajimet!

Vrapuan ditët si pulbardha
Tek rritej ëndërra
 që shpërthente;

Dhe çdo agim na gjen në radhë
Sikur të ishim monumente!

Këtu kaq shumë u dashuruam
Me punën,
tokën
~~WOKRI~~ edhe njëzet,
Mbi çdo kuotë
një flamur shtuam,
Si krenari
e këtij brezi!

FLAMUJT LART, RINIA IME

(Komandantes dhe shokëve
të mi vullnetarë)

Mahmudie, Mahmudie,
Sa të duan vullnetarët,
Ti je bërë midis tyre
Shqip e ngushtë,
e pandarë.

Pas çdo shtegu
nëpër turne
Ti kudo vrapon e para,
Hyn e del nga vjersha ime
Porsi flladi nëpër ara....

Nata hedh yje me grushta,
Yjet ecin mbi trase,
Tunden shallet ndënë gusha,
Vrapon larg një këngë e re.

Prozhektori ngijen mbrëmjen
Me flurudhën portokalle,
Ku rinia shpalos ëndërrën
Më të hekurt,
 më të madhe!

Flamujt lart rinia ime!
Mbi trase
 monto portretin,
Ndizi ngjyrat si agime,
Għidha vet-ċi monumentin!...

Komandante, komandante,
Ti do mbetesh midiș nesh
Porsi zjarret partizane,
Zjarr i ri
 me ne do jesh!...

Malta kien minn qiegħi
Widu kien minn qiegħi
 għidu kien minn qiegħi
 għidu kien minn qiegħi

Malta kien minn qiegħi
 għidu kien minn qiegħi
 għidu kien minn qiegħi
 għidu kien minn qiegħi

...
...
...
...
VIZION
...
...
...
...
...

Ti do të bëhesh poet i dëgjuar,
Vogëloshja më thoshte një herë.
Që ahene

shumë kohë ka shkuar
Dhe malit
ka fryrë.
tjetër erë

Rendëm nëpër gjurmë heroizmi
Vatrave të njerëzve tanë,
Dhe në male

zjarre të rinj ndiznim,
Kur marshonim porsi partizanë.

Shtigieve të egra hodhëm farë
Nuk e ndamë nushkën nga parmënda,
Dhe i deshëm kaq me shpirt ugaret
Sa i shihnim shpesh dhe nëpër ëndërra...

Me ditë e net
ndenjëm zgjuar

Dhe me njerzit u pleksëm,
u shkrimë.

Toka përmbi mal
duhej lëruar,

Përmbi mal
ne mbronim
dhe kufinë!

... Në u bëfsha poet i dëgjuar,
Nëpër vargje,
ndjenjat

do më mbinë.
Dhe nga netët që po rrimë zgjuar,
Malet do ta shtojnë krenarinë.

KETE TOKE

Në këtë tokë,
Ku gërshetohen milionë heroizma
gjeneratash
U thërmua tradhëtia,
dhe socializmi
i zjarrtë mbeti,
Këtë tokë.
që ka çarë historinë
me fringëllimë shpatash,
Sot,
si dinstinkтив të kuq
në gjoks e mban planeti!

1966,

VARRI I VETMUAR

Ky varr i vetmuar nazisti
që dergjet nën ollakën e murme,
Urrejtjen e madhe ma nxiti
T'ja derdhë të hidhur
Kur zbriti, pse erdhi? — E dimë!
Ckërmisi dhe dhembët e mprehtë,
La gjurmët me gozhdë mbi lëndinë
Ku bari iu bë bajonetë.
Dhe armët i zbrazi i egër
Tek toka jonë zemërmirë,
Na skuqi tërfillin e gjelbër,

Mbi lulet
kaluan zinxhirët!...
Kur flaka e luftës
u shua
Nazistin
kjo tokë
e strchoi,
Dhe balta e vendit
të huaj
Përpyjetë mbi trup,
i rëndoi.
Ka mbetur ky varr i vetmuar,
Tek zverdh bereqeti i jugës,
Si njollë e kohës së shkuar
Trofe
e urryer
e luftës!

DUKE ECUR NDANË DETIT

Dielli i kuq mbi det varet kurorë,
Si mbi një gjoks vigan dëshirash,
Valët çelin larg luleborë,
Dhe m'freskojnë mendimet në sfond ngjyrash.

Dielli zbriti tej në horizont,
Kur vala e najlontë e spërkat,
Unë, që ndanë detit eci sonte
S'mund të rri pa thurur ndonjë varg...

Muzgu u shpalos ngijyer në bakër
Horizonti si minierë digjet,
Gjoksin ma flladit ajér' i pastër:
Të pashkelur s'do t'i lemë shtigjet!
Vala bregun rreh me tërsëllimë
Këng' e detit oshëtin që larg,
Deti ngjan kaq shumë me rininë
Se ka shpirt të hekurt, luftarak.

Këtë breg të bruztë
ku treten valët,
Gjaku, porsi ujët e ka larë
Se vërshuan egër
dikur vandalët,
Dhe nga përleshjet,
lindën lapidarë!
Duke ecur sonte ndanë detit,
Një botë mendimesh
mbart mbi vete
Si monument lavdie këtu mbeti
Heroizmi i gdhëndur ndër vjete.

Udha zgjatet tutje ndënë muzgje,
Ku shkëmbinjtë val' e rreptë i mpreh
Jo, thjesht udhëtar
unë s'mund të quhem,
Kur për detin
ngrë një këngë të re!...

YJET PARTIZANE...

Mblidheshin rrreth zjarrit nëpër natë
Bisedonin për një aksion të ri,
Dëgjonin komandantin fjalëpakë
Dhe zemra u ndizej si yjet në kaltërsi.
Rreth zjarrit rrinin të rreckosurit
Cigaren e gjatë ndanin në qetësi,
I harronin dhimbjet të plagosurit,
Dh qielli zjarret i shihte me zili...
Koha rrodhi nér male e shtigje,
Qielli zjarret i futi në gji,
I mori me vete.
Sot, po të vëresh, n'udhëkryqe
Kanë zbritur yje mbi monumente!...

Motive Nëntori

«ENVER - MAO CE DUN!...»

Enver - Mao Ce Dun, buçasin megafonët, Ka ardhur në Kongres gjithë Shqipëria, Kjo thirrje bie si bombë përmbi frontet Ku rri e drithëruar borgjezia...

Enver - Mao Ce Dun, kudo sot po dëgjohet;
 Dhe nuk përbahet hovi, krenaria!
 Gjithë bota nga kjo thirrje lart çohet,
 Vështron si projektohet lumturia!..

DUKE DËGJUAR RAPORTIN E SHOKUT ENVER...

Duke dëgjuar raportin e shokut Enver,
Sikur vështroj me sy
Gjithë Shqipërinë,
Dhe vargu im fluturon gjer në eter,
Në ballë puth agimet që po vijnë!..

DELEGATI DHE VOGËLUSHJA

(Kushtuar delegatit S. Musta)

Një copë qiel me yje ke në gjoks,
Ndaj kurioze të sodit fëmja,
Ti buzëqesh,
 dhe s'mund t'i thuash dot...
Për dekoratat
 që të dha Partia!...

Nëntor 1966

LAPIDARI

Eshtë ulur diku përmbi kodër,
Në ballë një yll i ka çelur,
Ka zbritur nga shtigjet këtu më i fortë,
Sikur në zjarr pret pér t'u rihedhur.

ATOVININ

Ato vinin ngarkuar me pajime,
Fytyra e skuqur u nxirrte avull,
Sikur tē kishin lindur pēr marshime
Vraponin, edhe pushkë mbanin krahut.
Braktisën qetësinë, bulevardet
Dhe u futën në tē blertat radhë,
Shkelën baltra, ngjitëni monopate
Porsi krahë lumenjsh, tē pandarë.
Shpejtonin ngarkuar me pajime
Gratë tonë, gratë shqiptare;
Sikur tē kenë lindur pēr luftime,
Sikur tē kenë lindur thjesht ushtare.

NE UZINEN E TRAKTORAVE

Lëvizin agregatët e rëndë me zhurmë,
Furra elektrike hap gojën e zjarrtë,
Nga tubat ngrihet një avull i murrmë,
Derdhet në forma metali i artë.

Harku elektrik u ngijen fytyrat
E ashpra,
 të dirsura
 punëtorëve,
Zien nga vrulli,
 përflaket në ngjyra
Uzina e re e traktorave.

Vareja godet mbi detajet e kuqe,
Përhapen shkëndijat si meteorë,
Në brazda do futen më shumë plugje,
Atdheut do buçasin traktorë.

Vinça zgjat krahët e saj të fuqishëm

Mbi ne,

ngre lart mineralin,
Erdha këtu si punëtor i përditshëm,
Që nga tornua e mendimit
Vargje

të hekurta të dalin!

Lëvizin aggregatët e rëndë me zhurmë,
Detajet e skuqur rreh shtruar vareja,
Traktorë dhe grurë do ketë më shumë
Në fushat tona të reja.

MBI TËRTHINË
DHE KËTË PËRQËMISHË
SIPAS MËNÇURËVËS SË DITËS
DHE NËN VËRËVËS SË DITËS

I përfshikohet që dëshironi
LAÇ!... që do të bëjë
detyrën e vjetër që dëshironi
artët, këtë dëshirë që dëshironi
që dëshironi që dëshironi...

Qetësisë së breitur nga shekujt
I rrëmbeve heroikën stërgjyshore,
Mbi maskat e grisura të hasmërive
Ti ngrite lart oxhaqet madhështore;
Dhe me sirena qiejt i përpive!...

1966.

BABALLARET

Ata kthehen gjithmonë nga puna
Ashtu të urtë, t'ë menduar.
Mbi ballë kanë brazda me rrudha,
Në zemër, një zjarr të pashuar.
Baballarët i duam me shpirt.
Ata bënë luftën!
Dhe në këngët tonë përjetësisht
Me thjeshtësi partizane u futën...

SKËNDERBEU

Ai rend nga thellësitë
e kohrave
Mbi kreshta lavdie,
i përflikur
Sikur të mbrojë stinën e të korrave
Nga armiqtë e mundur,
të përgjakur.
Vrapon sëriish mbi kalin luftarak
Dhe tradhëtinë
në pluhur
e rrëzon,
Vështrimin si flurudhë
e ngul gjer larg,
Ku skuq dhe feks
përtej në horizont.
Potkojt trokojnë
e ngrënë lart duman,
Nga heroizmat
shpatat vetëtijnë,
Çdo gjurmë
dhe përleshje në tufan
Një trandafil të kuq
hedh mbi Lirinë!

Kështu vjen Skënderbeu ynë
Si një lavdi që s'shterron kurrë,
Ushtarët trima pas i rrinë
Me köngë, heshta
dhe flamurë...

BUROKRAT, BUROKRAT...

Zure dikur vend në një zyrë
Përpara kurdoherë
 mban një letër,
Ke kohë që i shqetësuar rri
Dhe natën shikonë ëndërra me «lugetër»

Kërkon të fshihesh ende pas gjyslykësh,
Kokën tullace
 ç'e mbështetët mbi grushta
Dhe ke të drejtë,
 nga zyra
 s'mund të ikësh
Se të djersitin malet
 edhe fushat...
Të ikësh ti?...
 që me orë mund të flasësh
Për mbeturinat...
 martesat me shkesa.
Kush tha
 që s'je lidhur me masën,

Dhe gjumi të zë shpesh
ashtu mbi shkresa?..
Ti mund të flasësh,
shumë mund të flasës
Citate të mësosh për natë,
Dhe prapë të mos jesh në gji të masës
Dhe prapë
do të quhesh burokrat!...
Nuk ke besim te njerëzit,
Pse të tmerron rinia?...
Kudo të ngjan sikur thëresin:
“Hej burokrat,
s’të mban më skrivania.
... Ti mundet ashpër të godasësh
Nomet,
martesat me shkesa
Dhe prapë të qëndrosh
shumë larg prej masës,
Dhe jetën ta vështrosh
ashtu nér shkresa...”

PASQYRA E LËNDËS

| | Faqe |
|-------------------------------|------|
| Përsëri | 3 |
| Partisë sime | 6 |
| Kam busull të ndritshme | 9 |
| Në zbor | 10 |
| Kënga ushtarake | 11 |
| Një mbledhje | 13 |
| Në dhomë | 14 |
| Në këtë qytet | 15 |
| Atë që doja | 16 |
| Poezi | 17 |
| Çast | 18 |
| Më thérresin udhët | 19 |
| Te malësorët | 20 |
| Vallzo vogëlushe | 21 |
| Kënga vullnetare | 22 |
| Mësuesja | 24 |
| Tarracat | 26 |
| Tregim aksioni | 27 |
| Flamujt lart, rinia ime | 29 |

Faqe

| | |
|---|-----------|
| Vizion | 31 |
| Këtë tokë | 33 |
| Varri i vetmuar | 34 |
| Duke ecur ndanë detit | 36 |
| Yjet partizane | 38 |
| «Enver – Mao Ce Dun!...» | 39 |
| Duke dëgjuar raportin e shokut Enver | 40 |
| Delegati dhe vogëlushja | 41 |
| Lapidari | 42 |
| Ato vinin | 43 |
| Në uzinën e traktorave | 44 |
| Laç | 46 |
| Baballarët | 47 |
| Skënderbeu | 48 |
| Burokrat, burokrat | 50 |

Tirazhi 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp NISh Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë 1968